

Instituti për Studime të Avancuara GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Obiliqit 2012

Nëntor, 2012

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje .....	4
2. Problemet në Komunën e Obiliqit.....	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Obiliqit.....	6
4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011 .....	11
5. Puna e Kuvendit Komunal .....	13
6. Administrata e Komunës së Obiliqit .....	14
7. Arsimi në Komunën e Obiliqit.....	15
8. Shëndetësia në Komunën e Obiliqit.....	16
9. Transparenca .....	18
10. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009 .....	20
11. Burimet.....	22

## Përmbledhje ekzekutive

Që nga zgjedhjet e para lokale në vitin 2000, komuna e Obiliqit është qeverisur nga ana e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Në zgjedhjet e fundit lokale të 2009, pas balotazhit kryetar komune u zgjodh z.Mehmet Krasniqi, i cili në raundin e parë të zgjedhjeve kishte më pak vota se kundër kandidati i tij. z.Krasniqi po i afrohet vitit të tretë të qeverisjes si kryetar komune. Instituti GAP, përmes këtij raporti, ka vlerësuar qeverisjen në nivel lokal, veçmas pas periudhës së zgjedhjeve të kaluara lokale.

Në territorin e kësaj komune operojnë dy termocentrale me bazë qymyri të cilat shkaktojnë ndotjen më të madhe në Evropë. Andaj, si pasojë e kësaj ndotje, shkaktohen dëme të mëdha në ambient, kontaminim të tokës, ajrit dhe ujit, ndikim të dëmshëm në shëndet.

Gjatë këtyre tri viteve të fundit, Komuna e Obiliqit është karakterizuar me disa raste të shpërfilljes së rregullave ligjore, konflikt interesi, shkallë relativisht të lartë të shpenzimit të parasë publike në disa kategori, mungesë transparence për shpenzimet që bënë ekzekutivi komunal, cilësia e ulët në arsim, etj.

Kësisoj, Komuna e Obiliqit ka shpenzuar për telefon më shumë se Klina, Kamenica, Malisheva, Prizreni dhe Lipjani të cilat komuna edhe në aspektin demografik edhe në atë gjeografik janë më të mëdha se Komuna e Obiliqit.

Kontraktimi i punëve për mirëmbajtjen e veturave zyrtare dhe servisimi i tyre është përcjell në Komunën e Obiliqit me parregullsi ligjore dhe me gabime evidente. Një kontratë e anuluar nga autoritetet e Obiliqit në fillim të këtij viti për servisim të veturave, në bazë të vlerësimeve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) rezulton që është bërë në mënyrë të jashtëligjshme dhe pa respektim të rregullave bazë të prokurimit publik. Gjatë periudhës fillimi i vitit 2011 deri në tetor të këtij vitit (2012) Komuna e Obiliqit ka shpenzuar për mirëmbajtje të veturave dhe servisimin e tyre afro 23.000 euro.

Infrastruktura shkollore dhe cilësia e arsimit në këtë komunë nuk është e kënaqshme. Gjatë këtyre viteve janë bërë meremetime në objekte të ndryshme shkollore, por kryetari nuk ka mbajtur premtimin për ndërtimin e dy shkollave të reja në fshatrat Lajthishtë dhe Babimoc. Kurse, kalueshmëria e testit të maturës nga maturantët e shkollës së mesme profesionale është një ndër më të ulëtat në Kosovë.

Qytetarët e komunës së Obiliqit janë më të rrezikuarit nga sëmundjet që shkaktohen nga kontaminimi i ambientit dhe produkteve jetësore. Sipas të dhënave të grumbulluara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe spitalet regjionale, shkalla e sëmundjes në organet respiratorë në komunën e Obiliqit është 30%, apo përgjysmë më e lartë në krahasim me komunat tjera. Vetëm gjatë periudhës së parë të 2012 në këtë komunë janë diagnostikuar gjashtë raste me kancer.

Premtimet e dhëna nga Kryetari i Komunës në fushatën e zgjedhjeve të fundit lokale të 2009 nuk janë përmbushur as për së afërmi. Progresi solid në fushën e infrastrukturës rrugore është manifestuar me cilësi të dobët të punimeve dhe tejzgjatje të afatit për kryerjen e punimeve.

## 1. Hyrje

Komuna e Obiliqit hyn në mesin e komunave mesatare për nga numri i popullsisë dhe madhësia e territorit. Në bazë të të dhënave të fundit të regjistrimit të popullsisë, Komuna e Obiliqit ka 21.549 banorë. Madhësia e territorit të kësaj komune është 105 km<sup>2</sup>. Komuna e Obiliqit, përbëhet prej 18 vendbanimeve: qytetit të Obiliqit dhe 17 fshatrave.<sup>1</sup> Emërtimin “Obiliq” kjo komunë e bartë që nga 1912. Edhe pse më 1999 një komision komunal për emërtimin e vendbanimeve, qytetin e ka emërtuar si qyteti i Kastriotit, edhe më tutje zyrtarisht kjo komunë mban emrin Komuna e Obiliqit.

Komuna e Obiliqit është një nga komunat më industriale të Kosovës. Në territorin e kësaj komune shtrihen rezervat nga më të mëdhatë të linjitet në Evropë dhe në territorin e kësaj komune operojnë dy termocentrale. Dymbëdhjetë zona kadastrale të kësaj komune, apo rreth 75% e territorit, shtrihet mbi “Fushën e Mihjes së Re” dhe në bazë të një vendimi të Qeverisë së Kosovës, këto zona hyjnë në kuadër të interesit të veçantë ekonomik, çfarë do të thotë se aktiviteti ekonomik i banorëve të këtyre zonave është i kufizuar dhe se banorët të zhvendosen nga pronat e tyre kurdo që Qeveria e Kosovës e sheh të nevojshme.<sup>2</sup> Pikërisht për shkak të aktivitetit të termocentraleve dhe mihjeve që ndodhen në këtë komunë, problemet më të mëdha në këtë komunë shkaktohen nga aktivitetet e termocentraleve. Andaj, zgjidhja e problemeve të qytetarëve të kësaj komune kërkon intervenimin e pushtetit qendror, po aq sa të atij lokal.

Kryetari i kësaj komune ka fituar mandatin e parë për Kryetar komune në zgjedhjet e fundit lokale të zhvilluara në fund të vitit 2009. Ai para se të merrte pozitën e kreut të komunës ka qenë anëtar i Kuvendit Komunal gjatë viteve 2000 - 2007, ndërsa nga viti 2007 deri në kohën e zgjedhjes së tij si Kryetar ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizimit në Komunën e Obiliqit. Në dy palë zgjedhjet e fundit për kryetar komune në Komunën e Obiliqit, fituesi i zgjedhjeve është vendosur pas balotazhit. Madje, në këtë komunë për dallim nga komunat e tjera, në të dy herët (në 2007 dhe 2009) kandidatët e LDK kanë arrit që në balotazh të kthejnë avantazhin në favor të tyre, edhe pse në raundin e parë janë radhitur të dytët, pas kandidatit të Partisë Demokratike e Kosovës (PDK).<sup>3</sup>

Kuvendi Komunal (KK) i Obiliqit përbëhet nga 21 anëtarë. Partia me numrin më të madh të përfaqësuesve në KK është PDK me gjashtë përfaqësues, pas saj vijnë LDK me

---

<sup>1</sup> Neni 11 i Statutit të Komunës së Obiliqit, mars 2010. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/obiliq/getattachment/Home/Statuti-i-Komunes.pdf.aspx>

<sup>2</sup> Për këtë shih raportimin e Institutit GAP për vendimin 2/57 të datës 13 mars 2012: GAP Monitor, shkurt 2009, fq.9-10. Burimi: <http://gapmonitor.org/publikimet/20110324102606950.pdf>

<sup>3</sup> Kjo ka ndodhur vetëm në dy komuna tjera, atë të Vitisë dhe Kamenicës (2009), ku kryetarët aktual në raundin e parë ishin radhitur të dytët, kurse në balotazh arritën të kthejnë shumicën në favor të tyre.

pesë, AAK po ashtu me pesë përfaqësues, tre përfaqësues ka Lëvizja për Bashkim (LB) dhe nga një përfaqësues kanë Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Partia e Drejtësisë (PD). Zyrtarisht LDK dhe AAK përbëjnë koalicionin qeverisës. Në kuadër të ekzekutivit të komunës funksionojnë nëntë drejtori, shtatë udhëhiqen nga LDK dhe dy nga partneri në koalicion AAK. Në këtë komunë nuk funksionon asnjë degë e pushtetit gjyqësor.

Përkundër asaj se komuna e Obiliqit konsiderohet si komunë industriale, papunësia në këtë komunë është në nivel të njëjtë me komunat tjera. Nga popullsia prej 21.549 banorësh, 7.094 qytetarë klasifikohen si ekonomikisht aktiv dhe prej tyre 3.799 janë të punësuar rregullisht. Niveli i papunësisë në këtë komunë është 47%. Prej 3.799 të punësuarve, 606 apo 15.9% të të punësuarve janë të angazhuar në sektorin publik komunal (administratë, arsim, shëndetësi).

Në këtë raport, Instituti GAP pasqyron zhvillimet në jetën publike komunale të Obiliqit, pas zgjedhjeve të fundit lokale dhe mbulon një periudhë prej janarit 2009 deri në tetor 2012. Raporti pasqyron problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët e kësaj komune, aftësitë buxhetore të komunës, të hyrat vetanake dhe investimet kapitale, aktivitetet e prokurimit publik, gjendjen në arsim, shëndetësi dhe administratë, transparencën e komunës dhe përmbushja e premtimeve zgjedhore të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të 2009.

## **2. Problemet në Komunën e Obiliqit**

Banorët e komunës së Obiliqit përballen me probleme të shumta, pjesa më e madhe e të cilave lidhet me aktivitetin e drejtpërdrejtë të dy termocentraleve dhe mihjeve sipërfaqësore. Mungesa e ujit të pijes, kontaminimi i tokës në shumë zona të Obiliqit nga derdhjet e termocentraleve, ndotja e ambientit, mungesa e trotuareve në shumë rrugë, prezenca në rritje e deponive të egra mbeturinash, ndotja e rrjedhjes së lumit Sitnica, mungesa e parqeve dhe këndeve rekreative-sportive, mungesa e ndriçimit publik, mos investimi në ndërtesat publike, mungesa e parkingjeve, janë vetëm disa nga problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët e Komunës së Obiliqit.

Gjendja nga mungesa e ujit të pijes në zonat dhe veçmas në fshatrat e Komunës së Obiliqit sa vjen e rëndohet. Gjendje më e keqe paraqitet në fshatrat e kësaj ane. Gjatë verës, fshati Mazgit dhe Plemetin i Obiliqit në pjesën më të madhe të kohës nuk kanë pasur ujë të pijes. Autoritetet komunale, ngjashëm si në rastin e Prishtinës dhe Fushë Kosovës, shpresat për përmirësimin e kësaj gjendjeje i mbështesin në ndërtimin e fabrikës së ujit në fshatin Shkabaj, që ndan administrativisht Komunën e Obiliqit nga Komuna e Prishtinës. Fabrika ka qenë e planifikuar që të nis së ndërtuari gjatë këtij viti, por kjo nuk ka ndodhur.

Përveç mungesës së ujit të pijes dhe cilësisë jo të mirë të tij në rastet kur ai ekziston, qytetarët e kësaj komune përballen edhe me problemin e kontaminimit të tokave bujqësore nga hiri fluturues i termocentraleve. Si pasojë, bujqit e kësaj komune nuk kanë rendimente të mira. Por edhe në rastet kur këta bujq arrijnë që të prodhojnë dhe t'i plasojnë produktet e tyre në treg, ata përballen edhe me hezitimin e blerësve për t'i blerë ato produkte bujqësore, për shkak të frigës se bartin sëmundje që vijnë nga hiri i termocentraleve.

Gjendja e përgjithshme ekologjike në Obiliq është e rëndë. Krahas termocentraleve, janë shumëfishuar deponitë e egra të mbeturinave. Në fshatin Mirash është hapur deponia regionale për hedhjen e mbeturinave, e cila gati vazhdimisht qëndron duke u djegur dhe kësisoj duke e tymosur qytetin. Po ashtu janë shpërndarë mbetjet e zinkut dhe plumbit nga Trepça në depon e Milloshevës. E terë kjo veçse ka përkeqësuar gjendjen ambientale në Obiliq.


Autoritetet janë treguar të pafuqishme t'i menaxhojnë mbeturinat në qytet. Në shumë zona janë krijuar deponi të egra, dy të tilla gjenden në fshatin Palaj dhe një në fshatin Mirash, ndërsa në gjithë hapësirën e komunës llogaritet të jenë disa të tilla. Mbeturinat hedhen edhe në lumin Sitnica.

Përgjegjësit e Komunës së Obiliqit nuk kanë arritur të mirëmbajnë si duhet vendet e gjelbëruara në qytet. Ato pak investime të bëra në krijimin e parqeve janë përcjell me mos mirëmbajtjen e tyre. Shembull për këtë është parku i qytetit që gjendet në afërsi të objektit komunal, i cili është rregulluar në verën e vitit 2011. Sot gjendja e tij është e keqe dhe si rrjedhojë ai park nuk mund të shfrytëzohet për pushim apo rekreacion. Iniciativat e shpeshta të nivelit qendror, përkatësisht të Ministrisë së Ambientit në partneritet me Komunën e Obiliqit për mbjelljen e fidanëve në qytet është shoqëruar me mungesë të përgjegjësisë për ujitjen dhe mirëmbajtjen e tyre, duke rezultuar kësisoj në tharjen e fidanëve dhe nxjerrjen e tyre nga ana e qytetarëve.

### **3. Performanca buxhetore e Komunës së Obiliqit**

Buxheti i komunës së Obiliqit sillet në mes të 3.5 milion eurove në vitin 2011 dhe 4.5 milion eurove për vitin e ardhshëm 2013. Sipas Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2013-2015, deri në 2015 buxheti i komunës nuk pritet të tejkalojë 4.7 milion euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbën granti qeveritar, i cili përbën mbi 84% të të hyrave totale të komunës. Kurse rreth 15% e buxhetit total të komunës mbushet nga të hyrat vetanake.

Grafikoni nr.1: Të hyrat vetanake komunale gjatë viteve 2009-2011 dhe planifikimi i të hyrave 2012-2015



Të hyrat vetanake komunale nuk kanë pasur rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Në vitin 2011 niveli i të hyrave ka qenë më i ulët se në vitin 2010. Sipas raportit nëntëmujor të buxhetit, në periudhën janar-shtator 2012, të hyrat vetanake komunale të komunës së Obiliqit janë 524.405 euro apo 9% më të mëdha se të hyrat e të njejtës periudhë të 2011. Deri në fund të vitit 2012 komunës i nevojiten edhe 155.000 për të arritur planin e të hyrave vetanake për këtë vit.


Pjesa më e madhe e të hyrave vetanake mbledhet nga tatimi në pronë (40.16% në vitin 2011), tarifat dhe ngarkesat (15.92%), lejet e ndërtimit (8.66%), etj. Të hyrat nga tatimi në pronë janë të mëdha në komunën e Obiliqit ngase mbi 66% e të hyrave janë nga KEK-u, ndërmarrje e cila i paguan komunës së Obiliqit tatim në pronë.

Nga regjistrimi i fundit i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Komuna e Obiliqit ka rezultuar t'i këtë gjithsej 21.549 banorë, ndërsa komisioni për ndarjen e granteve për komuna në nivel të Qeverisë së Kosovës deri më tani ka supozuar që Obiliqi ka 26.000 banorë. Mirëpo, përkundër këtij ndryshimi në numra, sipas planit afatmesëm për grantin për komunat 2013-2015, transferet qeveritare në vitet në vijim do të jenë më të mëdha.

Sa i përket ndarjeve buxhetore, pjesa më e madhe e buxhetit apo 56.5% shkon për paga të 606 punëtorëve komunal (arsim, shëndetësi, administratë, përfaqësuesit politik në


ekzekutiv dhe Kuvend); investime kapitale (33.4%), mallra dhe shpenzime (6.7%), shpenzime komunale (2.1%) dhe subvencione e transfere (1.1%).<sup>4</sup>

Grafikoni nr.2: Ndarjet buxhetore për periudhën 2009-2013 në komunën e Obiliqit



Përgjatë periudhës 2010-2013, aq sa zgjat mandati qeverisës i qeverisë aktuale komunale, në total kjo komunë do të ketë në menaxhim një buxhet prej 17.758.031 euro. Mbi 10 milion euro janë të destinuara për paga dhe mëditje, 5.4 milion për investime kapitale, 1.1 milion për mallra dhe shërbime, etj. Grafikoni më poshtë paraqet totalin e buxhetit nën menaxhim të kryetarit aktual z.Krasniqi.

Grafikoni nr.3: Ndarja e buxhetit total sipas kategorive buxhetore për vitet 2010-2013



<sup>4</sup> Kjo përlllogaritje për ndarjet buxhetore është bërë në bazë të buxhetit të vitit të fundit (2011). Por ndarjet e përafërta janë edhe për vitet tjera, siç mund të shihet nga grafikoni nr.2.



Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në vitin 2011 kanë qenë të shpenzuara 320.864 euro. Tabela 1 pasqyron disa lloje të shpenzimeve nga kategoria e “mallrave dhe shërbimeve”.

Tabela nr.1: Shpenzimet në disa linja në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në Komunën e Obiliqit gjatë 2011

Kategoria	Shuma (euro)
Karburante për vetura <sup>5</sup>	47.616,44
Shpenzimet në telefonin fikse	6.266,17
Shpenzimet në telefonin mobile	26.944,71
Dreka dhe darka zyrtare	12.971,30
Shpenzime për gjenerator (naftë)	16.507,69
Naftë për ngrohje	6.266,07

Nga të dhënat e Komunës rreth shpenzimit të buxhetit vërehet se Zyra e Kryetarit në një rast ka kryer pagesa me kredit kartelë personale për furnizim të veturës me karburante dhe pastaj shuma e shpenzuar nga kredit kartela është mbuluar nga të hollat e buxhetit komunal.<sup>6</sup>

Sa i përket shpenzimeve për telefoni fikse dhe mobile kjo komunë në total në 2011 ka shpenzuar 33.211 euro. Kjo shifër është dukshëm më e lartë se shpenzimet për telefon në komunën e Klinës (27.976 euro), Kamenicës (21.733 euro), Prizrenit (25.323 euro), Lipjanit (16.014 euro), Malishevës (18.161 euro), etj. Duke krahasuar komunën e Obiliqit me komunat tjera më të mëdha në numër të banorëve, territor dhe me largësi më të madhe nga qendra, duket qartë se në këtë komunë niveli i keqpërdorimit të drejtës për të përdorur telefonin zyrtar (sidomos atë mobil) është i lartë.

Për dy vite, Komuna e Obiliqit ka shpenzuar 71.700 euro për blerjen e automjeteve zyrtare. Në vitin 2010, Komuna e Obiliqit ka shpenzuar 59.210 euro për blerjen e automjeteve zyrtare. Vetëm vetura e kryetarit ka kushtuar afro 31.000 euro. Kurse në vitin 2011 komuna ka blerë një automjet të tipit Hyundai në vlerë prej 12.490 eurove.

Tabela nr22: Lista e automjeteve zyrtare të Komunës së Obiliqit

Nr	Lloji i automjetit	Sasia	Viti i prodhimit	Vëllimi i motorit	Lloji i karburantit
1	Xhip Hyundai	1	2010	2.8	Dizel
2	“Hyunday”	3	2010/2011	1.4	Benzin

<sup>5</sup> Në shumën e mjeteve të shpenzuara (karburant për vetura) 10.077.04 euro janë paguar në vitin 2011, ndërsa janë shpenzuar në vitin 2010.

<sup>6</sup> Komuna e Obiliqit. Kartela analitike e shpenzimeve për karburante 2011.

3	“Hyunday”	2	2005	1.4	Benzin
4	“Tyota Xhip”	1	2000	3.0	Dizel
5	“Tyota”	1	2000	1.6	Benzin
6	“Golf4”	1	2002	1.9	Dizel
7	“Golf3”	1	1997	1.9	Dizel
8	“Polo”	1	2000	1.9	Dizel
9	“Reno Clio”	1	2003	1.2	Benzin
10	“Piago Porter”	2	2003	1.2	Benzin
11	“Fiat Stilo”	1	2002	1.6	Dizel
12	minibus Tyota”	3	2001	3.6	Dizel
13	Autoambulanc “Mercedes”	1	1997	2.0	Dizel
14	Autoambulanc “Mercedes”	1	2002	2.0	Dizel
15	Autoambulanc Mercedes-vita	1	2000	2.4	Dizel
16	Autoambulanc VV	1	2002	2.4	Dizel

Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të komunës është e kushtueshme. Në nëntor të vitit 2011 Komuna e Obiliqit ka lidhur një kontratë për servisim dhe mirëmbajtje të veturave në vlerën e 2.936 eurove. Kontrata e dytë e lidhur në dhjetor 2011 kap vlerën e 119.397,50 eurosh<sup>7</sup>; kontrata e tretë e lidhur në prill 2012 kap shumën e 47.757,50 euro<sup>8</sup>; dhe kontrata e katërt është e korrikut 2012 dhe kap shumën e 1.800,60 eurove.<sup>9</sup> Kontrata e dytë e lidhur në dhjetor në shumën e 119.397,50 eurosh është anuluar nga Zyra e Prokurimit e Komunës së Obiliqit me arsyetimin e lëshimeve të gabimeve gjatë specifikimit të çmimit dhe pajisjeve të përfshira në çmim. Dosja e anulimit të tenderit mungon në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Anulimi i kontratës nga ana e Komunës së Obiliqit është bërë duke formuar një komision në përbërje të tre zyrtarëve të komunës. Pas anulimit të kontratës e cila ka qenë e lidhur me operatorin “Autoservis Sistem” është shpallur tenderi i ri, ku prapë operatori “Autoservis Sistem” ka fituar të drejtën e lidhjes së kontratës, por kësaj radhe jo me çmimin e 119.397,50, por në vlerë të 47.757,50. Instituti GAP për këtë çështje ju ka adresuar Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) të cilët mënyrën e veprimit nga ana e Komunës së Obiliqit e kanë cilësuar jo ligjore dhe jashtë rregullave të prokurimit publik. “Komuna e Obiliqit nuk ka të drejtë të anulojë kontrata të cilat janë lidhur me procedurë të tenderimit. Institucionet që lidhin kontratë me procedurë të

<sup>7</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=53103>

<sup>8</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=56189>

<sup>9</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=59650>

tenderimit, mund të anulohet atë vetëm pas adresimit të lendes në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe OSHP është kompetente për të vlerësuar gabimet dhe pas vendimit të OSHP një kontratë e lidhur përmes procedurave të tenderimit mund të anulohet”.<sup>10</sup> Në faqen zyrtare të KRPP publikohen njoftimet për anulim të kontratës së lidhur vetëm me vendim të OSHP. Sipas rregullave të prokurimit publik, servisimi i veturave dhe mirëmbajtja e tyre bëhet në formën e kontratë kornizë, çka do të thotë se parashihet një vlerë e pasurisë së aseteve dhe me pastaj mirëmbajtja e tyre bëhet varësisht nga nevoja dhe pagesat ekzekutohen varësisht nga sasia e punëve. Tek rasti i Obiliqit, kontrata aktualisht në fuqi është ajo e vlerës 47.757,50 me autoservisim “Auto Sistem Servis” me seli në fshatin Mazgit të Obiliqit. Komuna e Obiliqit gjatë vitit 2010-2011 ka shpenzuar për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve ka afro 23.000 euro. Pwr vitin 2013 janw parapwr edhe 14.000 euro pwr servisim tw veturave.

Ndërtimi i një “bil-bordi” në qendër të qytetit të Obiliqit është paraparë t’i kushtojë Komunës 9.892 euro. 50% e mjeteve janë dhënë nga “Raiffaisen Bank” e cila për pesë vite do të shfrytëzohet rreth 50% të hapësirës së “bil bordit”. Në komunat tjera “bil-bordet” vendosen nga ana e kompanive private me një marrëveshje paraprake me komunën dhe menaxhohen nga ana e asaj kompanie. Nuk dihet se pse Komuna e Obiliqit e ka ndjerë nevojën e vendosjes së këtij “Bil-Bordi” në qendër të qytetit. Kostoja e vendose se saj del të jetë me e lartë se kostoja e vendosjes së kabinave në stacionet e autobusëve, gjë e cila nuk është bërë nga ana e Komunës deri më tani me arsyetimin e mungesës së buxhetit.<sup>11</sup>

#### 4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011

Komuna e Obiliqit fushën e prokurimit publik e ka të rregulluar në nivel të zyrës e cila sipas organogramit funksionin brenda Drejtorisë së Administratës. Kjo zyre ka gjithsej tre të punësuar, ku njëri nga ta mban pozitën e Shefit të Zyrës së Prokurimit. Për dy vite (2010-2011), Komuna e Obiliqit ka lidhur mbi 202 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave mbi 3.6 milion euro.

Tabela nr.2: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Obiliqit 2010 -2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave
2010	90	1.684.307,06
2011	112	1.949.123,84
<b>Totali</b>	<b>202</b>	<b>3.633.430,90</b>

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

<sup>10</sup> Bisedë me Abdyl Limanin. Ekspert ligjor në KRPP, tetor 2012.

<sup>11</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Burimi: <http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=58396>

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në raportin e vitit 2011 ka gjetur disa anomali në sferën e prokurimit publik në komunën e Obiliqit , anomali këto që Auditori i ka kategorizuar me rrezikshmëri të lartë.<sup>12</sup> Disa nga projektet më të diskutueshme sipas Auditorit janë:

- Projekti për ndërtimin e rrugës Palaj-Sibovc, me numër të kontratës 61411065521 dhe shumë të kontraktuar 226.073 euro. Ky rast ka shkuar në ri-tenderim dhe arsyet për ri-tenderim nuk kanë qenë të dokumentuara, megjithëse dosja e këtij tenderi ka qenë nën hetim nga ana e Agjencisë Kundër Korrupsion (AKK) dhe Auditori është njoftuar se menaxheri i prokurimit e ka anuluar në bazë të rekomandimeve verbale nga AKK. Megjithatë ky projekt është tenderuar për herë të dytë dhe oferta fituese ka qenë për 28.876 euro më e lartë se ajo në tenderin e anuluar. Auditori ka identifikuar se ka munguar sigurimi i ekzekutimit të punëve. Raporti i punë-kryesit dhe mbikëqyrësit nuk është bërë për dy kështet e paguara në shumën prej 11.000 euro. Për më tepër, Komuna e Obiliqit ka nënshkruar aneks kontratë me operatorin në shumën 22.504 euro vetëm 13 ditë nga nënshkrimi i kontratës bazë.<sup>13</sup>
- ZAP në raportin e tij, tek fusha e prokurimit publik, gjen se tenderi për ndërtimin e rrugës se quajtur “Durrësi”, me numër kontrate 614- 11017521 dhe shumë të kontraktuar 100.110 euro, është anuluar një herë me arsyen se janë bërë gabime në paralogaritë e projektit dhe se ka pasur dallime në mes të para masës dhe mjeteve të zotuar. Për më tepër, sigurimi i ekzekutimit të punëve nuk ka qenë valid gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të punëve.
- Po ashtu, sipas ZAP, në ndërtimin e rrugës Mazgit-Magjistrale, me numër kontrate 61411043521, dhe shumë të kontraktuar 173.859 euro, Komuna ka filluar procedurat e prokurimit para se të nënshkruhet deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve. Për më tepër, aneks kontrata e nënshkruar më 9 Nëntor 2011 në shumë 14.861 euro, nuk ka qenë e paraqitur në raportin e kontratave të nënshkruara.

Sipas të dhënave të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), i cili njihet ndryshe si “grykëta e tenderëve”, nuk është paraqitur ndonjë rast i ankesës gjatë vitit 2011 nga ana e operatoreve privat ndaj Komunës së Obiliqit. Kjo nxjerr në pah se operatorët privat kanë nisur të shfrytëzojnë Agjencinë Anti-Korrupsion për t’i paraqitur ankesat e tyre, ngjashëm si tek rasti i evidentuar nga ana e Auditorit të Përgjithshëm në tenderin për ndërtimin e rrugës Palaj-Sibovc.

---

<sup>12</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunen e Obiliqit 2011. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Obiliqi\\_31\\_12\\_2011\\_Final\\_alb\\_801244.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Obiliqi_31_12_2011_Final_alb_801244.pdf)

<sup>13</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunen e Obiliqit 2011. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Obiliqi\\_31\\_12\\_2011\\_Final\\_alb\\_801244.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Obiliqi_31_12_2011_Final_alb_801244.pdf)

Përgjegjësit e Komunës janë treguar të pavullnetshëm për të parandaluar dhe sanksionuar rastet e konfliktit të interesit. Një ndër supermarketet me të mëdhenj në Komunë të Obiliqit (supermarketi "Buvies") është nën menaxhimin e nënkryetarit të Komunës Hajrullah Sallova. Kryetari i Komunës së Obiliqit për festat e fundvitit 2011 u jep me një vendim nga 50 euro tre punëtoreve të angazhuar në komunë për mirëmbajtjen e objektit dhe në bazë të atij vendimi i obligon këta punëtor që ato mjete të marra nga komuna të shpenzohen vetëm në supermarketin 'Buvies'. Ngjashëm ekzekutivi i komunës ka vepruar edhe me punëtorët e shëndetësisë të angazhuar në ndërrimin e natës dhe për një pjesë të punëtoreve të arsimit të cilëve Komuna arsyetohet se nuk ka mjete për t'ua paguar mëditjet e caktuara dhe në vend të kësaj kërkon nga ata që të shkojnë në supermarketi "Buvies" dhe të furnizohen me mallra të konsumit ditor në vlerë deri 30 euro për person. Në raportin vjetor të Komunës së Obiliqit për vitin 2011 figuron shuma prej rreth 5 mijë euro të shpenzuara nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë të cilat mjete janë shpenzuar për koktej rasti dhe gjitha këto mjete kanë shkuar në xhironlogarinë e supermarketi "Buvies". Po ashtu, Çerdhja e qytetit të Obiliqit mallrat e konsumit ditor i siguron nga supermarketi "Buvies". Për më tepër, Ekzekutivi i Komunës i ka dhënë pëlqimin supermarketit "Buvies" që të vendos një tezgë shitëse afër ambulancës së qytetit për të shitur mjete piroteknike për festat e fundit vitit.

## 5. Puna e Kuvendit Komunal

Kuvendi Komunal dhe Komiteti për Politikë dhe Financa përgjatë periudhës janar 2010 – qershor 2012 kanë mbajtur takime të rregullta, konform Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Komuna e Obiliqit dy herë brenda një viti i dërgon të gjithë këshilltaret komunal për vizitë në Shqipëri. Vetëm për këshilltaret për këto dy vizita dedikohen dhe shpenzohen rreth 5.000 euro. Vizitat në Shqipëri realizohen përgjithësisht në fillim dhe fund të sezonit veror dhe koha e qëndrimit është 3 deri në 4 ditë. Shkuarja e këshilltareve komunal në Shqipëri bëhet me arsyetimin e takimeve zyrtare me homologë nga Shqipëria. Në vizitat e vitit 2011 në agjendë kanë qenë të parapara dy takime të tilla, njëri me përfaqësuesit e komunës së Durrësit dhe tjetri me përfaqësuesit e Komunës së Vlorës, por asnjëra nga këto takime nuk është realizuar.

Ekzekutivi i Komunës u ka ndaluar mëditjet për muajin mars të këtij viti grupeve opozitare në Kuvendin e Komunës, për arsye se këto grupe e kanë lëshuar demonstrativisht seancën e Kuvendit, ngase nuk janë pajtuar me mënyrën se si ekzekutivi ka ndërhyrë në një vendim për transparencë, me ç'rast ekzekutivi, sipas grupeve opozitare, ka ndryshuar votat e asamblistëve duke e rritur numrin e votave

kundër vendimit për transparencë. Pas një muaji mëditjet e ndala u janë ofruar këshilltarëve.

Komuna u ka blerë të gjithë këshilltarëve nga një laptop kompjuter. Në vitin 2011, për këtë qëllim janë dhënë 8.118 euro, kurse gjysma tjetër e mjeteve është siguruar nga USAID. Sipas zyrtarëve komunal, qëllimi i blerjes së këtyre laptopëve është shkëmbimi i njoftimeve, materialeve dhe shkresave tjera në mënyrë elektronike. Mirëpo, edhe pas blerjes së laptopëve, i gjithë materiali shpërndahet si më parë në formë jo elektronike.

## 6. Administrata e Komunës së Obiliqit

Nga numri i përgjithshëm prej 606 të punësuarve në sektorin publik në komunën e Obiliqit<sup>14</sup>, 110 janë të punësuar në kuadër të administratës lokale. Nëse krahasojmë numrin e shërbyesve civil me numrin e banorëve, del se një shërbyes civil u shërben 195 banorëve. Sipas një vendimi të Qeverisë së Kosovës për kriteret e madhësisë së administratave komunale, në komunat nën 100.000 banorë, siç është Obiliqi, një shërbyes civil duhet t'u shërbejë 780 qytetarëve.<sup>15</sup> Sipas kësaj formule, del se administrata e komunës së Obiliqit është e mbingarkuar me shërbyes civil.

Në administratën komunale të Obiliqit nuk ka pasur lëvizje të shumta të punëtorëve dhe largime në baza partiake. Kjo komunë që nga zgjedhjet e para të 2009 qeveriset nga LDK dhe sipas bashkëbiseduesve gjatë hulumtimit, administrata e Obiliqit që nga fillimi është mbushur me përkrahës të LDK. Por përkundër kësaj, gjatë këtyre viteve nuk kanë munguar ankesat e qytetarëve sa i përket trajtimit në punë dhe praktikat e punësimit. Në vitin 2011, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (KPM) janë pranuar pesë ankesa të qytetarëve kundrejt Komunës së Obiliqit. Dy nga ankesat kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit. Në dy nga pesë rastet, KPM ka vendosur në favor të të dëmtuarve, por Komuna nuk i ka respektuar vendimet e KPM.<sup>16</sup> Edhe në vitin 2010 KPM ka vendosur në favor të dy rasteve të ankuesve, kurse njërin nga ta nuk e ka zbatuar me kohë Komuna e Obiliqit.<sup>17</sup>

Auditori i Përgjithshëm i Kosovës në raportin e fundit i cili i referohet periudhës së vitit të kaluar, ka hasur në parregullsi në dosjet e personelit të Komunës së Obiliqit ku ka

---

<sup>14</sup> Ministria e Financave. Raporti Nëntëmujor i Buxhetit 2012.

<sup>15</sup> Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/46 i datës 03.12.2008. Burimi: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_46-te\\_te\\_Qeverise\\_2008.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_46-te_te_Qeverise_2008.pdf)

<sup>16</sup> Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Raporti Vjetor 2011. Publikuar në mars 2012. Burimi: [http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/Raporti\\_Vjetori\\_2011\\_972731.pdf](http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/Raporti_Vjetori_2011_972731.pdf)

<sup>17</sup> Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Raporti 2010. Publikuar në mars 2011. Burimi: [http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/raporti\\_2010\\_509186.pdf](http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/raporti_2010_509186.pdf)

identifikuar disa raste kur dosjet e personelit nuk kanë qenë të kompletuara. Kanë munguar dokumentet e kualifikimit dhe dokumentacioni tjetër i stafit në lidhje me rekrutimin dhe vlerësimin. Gjithashtu, në disa raste është vërejtur se listat e pagave nuk janë të nënshkruara nga të gjithë punëtorët, apo raste kur një punëtor ka nënshkruar në emër të një punëtori tjetër.<sup>18</sup>

Administrata e komunës së Obiliqit është e vendosur në disa objekte në qytetin e Komunës, objekte të cilat nuk i plotësojnë kushtet për punë, për shkak të vjetërsisë, hapësirës së pamjaftueshme dhe vendndodhjes së tyre. Më 2011, në Obiliq ka filluar së ndërtuari objekti i ri i administratës komunale, me një kosto prej 1.5 milion euro.

## 7. Arsimi në Komunën e Obiliqit

Në komunën e Obiliqit funksionojnë gjashtë shkolla fillore dhe 10 paralele të ndara, dy shkolla të mesme dhe një çerdhe. Në çerdhen e qytetit janë të sistemuar afro 80 fëmijë. Në sistemin e arsimit parafillor janë të sistemuar 321 nxënës, në atë fillor 2.058 nxënës, në arsimin e mesëm të ulët 1.539 nxënës dhe në arsimin e mesëm të lartë 978 nxënës. Në këtë komunë funksionojnë edhe katër shkolla fillore në gjuhën serbe, të cilat punojnë me plan programe të Ministrisë së Arsimit të Serbisë. Numri total i nxënësve në shkollat serbe është 537.

Tabela nr.3: Numri i mësimdhënësve dhe stafi përcjellës në shkollat fillore dhe të mesme të Obiliqit

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	147	6
Meshkuj	139	46
<b>Gjithsej</b>	<b>286</b>	<b>52</b>

Në komunën e Obiliqit gjatë dy viteve të kaluara nuk ka pasur asnjë nismë për ndërtimin e ndonjë objekti të ri mësimor. Objektet përgjithësisht janë të vjetra dhe investimet gjatë kësaj periudhe janë fokusuar më shumë në riparimin dhe meremetimin e tyre, gjë kjo e cila nuk ka rezultuar me ndryshime esenciale në infrastrukturën shkollore. Gjatë fushatës zgjedhore lokale të 2009, kryetari aktual kishte premtuar ndërtimin e objekteve të reja shkollore në fshatrat Lajthishtë dhe Babimoc.

Sa i përket rezultateve të maturës dhe arritshmërisë, nxënësit e kësaj komune në vitet 2008 dhe 2009 kanë pasur rezultatet më të dobëta në krahasim me komunat tjera. Vitet e fundit kalueshmëria është përmirësuar, mirëpo edhe më tutje niveli i kalueshmërisë së

<sup>18</sup>Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Obiliqit 2011. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Obiliqi\\_31\\_12\\_2011\\_Final\\_alb\\_801244.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Obiliqi_31_12_2011_Final_alb_801244.pdf)

nxënësve në shkollat e Obiliqit është shumë i ulët, sidomos i atyre të shkollës së mesme profesionale.

Tabela nr.4: Rezultatet e kalueshmërisë së testit të maturës në dy shkollat e mesme në komunën e Obiliqit

Shkolla	2011				2012		
	Afati				Afati		
	Qershor		Gusht		Qershor		Gusht
	I u nënshtruan testit të maturës	Kaluan me sukses	I u nënshtruan testit të maturës	Kaluan me sukses	I u nënshtruan testit të maturës	Kaluan me sukses	-
Gjimnazi "17 shkurti"	83	60 (72%)	18	13 (67%)	102	70 (69%)	-
Sh.M. profesionale "Hasan Tahsini"	125	27 (22%)	131	57 (43.5%)	108 të rregullt	27.8%	-
					79 të gjeneratave të kaluara	3 (3.8%)	-
					30 nxënës te arsimit për të rritur	4 (13.3%)	-

Arsimi profesional në komunën e Obiliqit është sektor me rëndësi i arsimit në këtë komunë, për shkak të mundësive më të mëdha të punësimit në sektorin e energjisë (termocentralet dhe minierat). Por, shkolla profesionale nuk kanë treguar rezultate të mira viteve të fundit sa i përket cilësisë.

Në vitin 2011 nuk kanë arritur që ta kalojnë testin e maturës 55.5% e nxënësve të shkollës profesionale. Ata të cilët nuk arrijnë të kalojnë testin e maturës në vitin kur edhe kryejnë studimet, e kanë shumë më të vështirë që ta kalojnë testin në vitet në vazhdim. Në vitin 2012, në afatin e qershorit, nga 79 nxënës të shkollës profesionale që ishin të gjeneratave të kaluara, vetëm 3 prej tyre kanë arritur të kalojnë testin. Si rrjedhojë, nga viti në vit rritet numri i nxënësve të cilët nuk kanë arritur të pajisen me diplomë të shkollës profesionale.

## 8. Shëndetësia në Komunën e Obiliqit

Qytetarët e komunës së Obiliqit janë më të rrezikuarit nga sëmundjet që shkaktohen nga djegia e qymyrit. Shumë banorë që jetojnë përreth termocentraleve ankojnë nga sëmundje të ndryshme të frymëmarrjes, kancerit, sëmundje kardio-vaskulare, sëmundje të syve, etj. Sipas të dhënave të grumbulluara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe spitalet regjionale, shkalla e sëmundjes në organet respiratore në komunën e Obiliqit është 30%, apo përgjysmë më e lartë në krahasim me komunat tjera mesatarja



e të cilave sillet në 14.26%.<sup>19</sup> vetëm gjatë periudhës së parë të 2012 në këtë komunë janë paraqitur gjashtë raste me kancer.<sup>20</sup>

Përkundër këtij rreziku, qytetarët dhe sektori i shëndetit publik në komunën e Obiliqit, nuk marrin trajtim të veçantë nga Ministria e Shëndetësisë. Kostoja e shërimit, si pasojë e sëmundjeve të shkaktuara nga aktiviteti i termocentraleve, mbulohet nga vetë qytetarët.

Në kuadër të Komunës së Obiliqit funksionon Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, dy qendra të mjekësisë familjare dhe pesë punkte shëndetësore. Gjatë qeverisjes aktuale janë funksionalizuar disa pajisje të cilat kanë qenë donacione nga organizatat dhe shtetet e jashtme. Megjithëse në dy vitet e fundit janë bërë disa investime në shëndetësinë primare në Obiliq, gjendja e përgjithshme mbetet e njëjtë me atë të para zgjedhjeve lokale të vitit 2009. Totali i të punësuarave në sektorin e shëndetësisë në Komunën e Obiliqit është 109.

Tabela nr.5: Numri dhe pozitat e të punësuarave në sektorin e shëndetësisë në Obiliq

Pozitat	Numri
Mjek përgjithshëm	15
Specialistë	8
Pediatër	3
Mami	5
Dentist/teknik	9
Radiolog	2
Infermier	45
Laborant	5
Staf ndihmës /administratë, pastrim, arkivim, vozitës	17
<b>Gjithsejtë</b>	<b>109</b>

Gjatë vitit 2012 në kujdesin primar shëndetësor në Obiliq kanë kërkuar ndihmë 57.520 pacientë.<sup>21</sup> Komuna e Obiliqit ka 21.519 banorë, çka do të thotë se shumica e popullsisë ka vizituar shëndetësinë primare më shumë se një herë brenda vitit. Por një numër i madh i rasteve referohen në sektorin, ku vetëm gjatë 2011 janë referuar 5.187 raste. Për shkak se në regjionin e Prishtinës nuk funksionon spital i veçantë që kryen shërbimet sekondare, të gjitha rastet referohen në QKUK.

<sup>19</sup> Dr.Xhevat Pllana. Instituti i Mjekësisë së Punës dhe Mbrojtjes Radiologjike. Prezantimi me titull “Sëmundjet respiratore dhe sëmundjet tjera si pasojë e ndikimit të thëngjillit në shëndet”, 1 nëntor 2012, Prishtinë.

<sup>20</sup> Komuna e Obiliqit. Raporti Gjashtëmujor 2012–Raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

<sup>21</sup> Komuna e Obiliqit. Raporti Njëvjeçar 2011–Raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Për shumë vite komuna e Obiliqit është shërbyer vetëm me një autoambulancë dhe kjo ka paraqitur problem të madh në rastet emergjente. Në vitin 2011 Obiliqi ka përfituar donacion një autoambulantë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme. Për vitin 2012 komuna shpreson të përfitojë një autoambulantë tjetër nga një donacion francez.

Në përgjithësi, sektori i shëndetësisë në këtë komunë përballet me probleme të shumta. Duke marr parasysh specifikat e kësaj komune, niveli qendror duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë kësaj komune, duke i siguruar grant më të madh të shëndetësisë në krahasim me komunat tjera. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet atyre shërbimeve të cilat trajtojnë sëmundjet e shkaktuara drejtpërdrejtë nga aktiviteti i termocentraleve.

## 9. Transparenca

Zyra për Informim në komunën e Obiliqit funksionon brenda Zyrës së Administratës dhe ka vetëm një person të punësuar. Kjo Komunë mbulohet rrallë nga mediumet e shkruara dhe ato elektronike. Asnjë medium i nivelit qendror nuk ka korrespondent nga ky lokalitet. Mediumet qendrore kohë pas kohe i mbulojnë zhvillimet nga Komuna e Obiliqit.

Komuna e Obiliqit është njëra ndër komunat ku më së paku gjen të dhëna, informata dhe dokumente në ueb faqen e saj zyrtare. Në këtë ueb faqe nuk mund të gjesësh asnjë raport për buxhetin apo për mënyrën dhe fushat e shpenzimit të parasë publike. Shkalla e informatave në fushat e tjera janë gjysmake dhe të vjetruara në kohë. Nuk publikohen as procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe po ashtu nuk hasen të kompletuara njoftimet për publikimin e aktiviteteve të prokurimit apo të shpalljeve të tjera më rëndësi për opinionin.

Gjatë vitit 2011 nuk ka pasur asnjë kërkesë për qasje në dokumente publike<sup>22</sup>, kurse vetëm në gjashtë mujorin e parë të 2012 janë dorëzuar shtatë kërkesa për qasje në dokumente publike.<sup>23</sup> . Në vitin 2012, Instituti GAP ka dërguar kërkesë për qasje në të dhënat e detajuara të shpenzimit të buxhetit të komunës për karburante, dreka zyrtare dhe telefona, dhe kemi marr përgjigje pozitive. Por të dhënat e dërguara nga Komuna e Obiliqit, sidomos pjesa për shpenzimet e karburanteve, ka qenë informatë e pasaktë.

Tabela më poshtë pasqyron përmbajtjen e uebfaqes së Komunës së Obiliqit.

---

<sup>22</sup> Komuna e Obiliqit. Raporti Njëvjeçar 2011.

<sup>23</sup> Komuna e Obiliqit. Raporti Gjashtëmujor 2012.

Tabela nr.6: vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Obiliqit

<http://kk.rks-gov.net/obiliq/>

Dokumenti	2010				2011				2012		
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Ekonomi, Financa dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Shërbimet Publike dhe Emergjencë	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Mbrojtje të Mjedisit	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	Në uebfaqen e komunës janë publikuar vetëm 16 njoftime të prokurimit, kurse përgjatë viteve 2010-2011 kjo komunë ka lidhur 202 kontrata të prokurimit publik. Shprehur në përqindje, komuna ka publikuar vetëm 7.9% të njoftimeve (pa llogaritur njoftimet e 2012).										
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm	x										
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x				(Në uebfaqen e komunës janë të publikuara vetëm dy procesverbale të 2011)				x		
Rregulloret Komunale	√										
Vendimet e Kuvendit Komunal	x				x				x		
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x										
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	Është e publikuar vetëm Kroniza Afatmesme e Shpenzimeve 2013-2015.										

X = mungon raporti. √= raporti është i publikuar në ueb-faqe.

## 10. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Mehmet Krasniqi, para elektoratit të tij ka shpalosur shumë premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë vlerëson progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 13 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në Komunën e Obiliqit, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 2 premtime janë përmbushur, 9 nuk janë realizuar, ndërsa në 2 premtim ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen premtime të përmbushura.

Premtimet	Realizueshmëria
Hapjen e vendeve të reja të punës, me ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”.	Ky premtim zgjedhor nuk përkon me kompetencat e nivelit lokal të qeverisjes. Ndërtimi i termocentralit është kompetencë e nivelit qendror. Ky termocentral nuk ka filluar së ndërtuara.
Ndërtimin e shkolla të reja dhe rritja e cilësisë në arsim.	Asnjë shkollë e re nuk ka filluar së ndërtuari nga viti 2010, kohë kjo kur ka nisur edhe ushtrimi i mandatit të kryetarit aktual të Obiliqit. Objektet shkollore në Obiliq janë të tepër të vjetruara dhe Komuna ka investuar vetëm në riparimin dhe meremetimin e tyre.
Reformimin e administratës.	Administrata komunale vazhdon të mbetet ajo që ka qenë pa pasur ndonjë ndryshim esencial as në personel dhe as në infrastrukturë të administratës krahasuar me kohën e para zgjedhjeve lokale të 2009.
Rrugë të reja, asfaltimin e rrugëve në qytet dhe fshatra.	Në këtë drejtim ka pasur përpjekje për t’u përmbushur planet e parapara, por mbetet shqetësuese cilësia e dobët e punimeve. Kësisoj rrugët e posa rregulluara janë dëmtuar në masën me të madhe. E tillë vlerësohet rruga “Hasan Prishtina” për në fshatin Subotiq e cila disa ditë pas asfaltimit ka filluar të dëmtohet dhe të hapen gropa përgjatë rrugës së asfaltuar.

Ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës	Ky premtim nuk është realizuar as në vitin e tretë të qeverisjes. E tëra qfarë ka bërë komuna është adresimi i kërkesave tek donatorët dhe niveli qendror për të financuar ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës. Në 2012 komuna ka dërguar një kërkesë në MAPL për të financuar këtë objekt, i cili parashihet të kushtoj 950.000 euro.
Ndërtimin e urës në Hamidi.	Nuk është realizuar. Edhe pse komuna ka investuar në projekte të ndryshme në fshatin Hamidi (ndërtimi i rrugëve, rregullimi i lapidarit të dëshmorëve dhe varrezave), ura e premtuar nuk është realizuar.
Kanalizimin në fshatin Sibofc.	Projekt i realizuar. Në 2011 komuna e Obiliqit ka shpenzuar 6.960 euro për hartimin e projektit të kanalizimit në Sibofc dhe në të njëjtin vit ka angazhuar kompaninë punëkryese për punët në kanalizimin në Sibofc me një vlerë të kontratës prej 213.473 eurosh. Fillimisht kompania punëkryese ishte angazhuar për 195.976 euro, por më vonë, përmes aneks kontratës, i janë dhënë edhe mbi 17 mijë euro.
Ujësjellësin në fshatrat Brenicë dhe Kozaricë	Kjo ka filluar para 2 viteve dhe akoma nuk është funksionalizuar.
Ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Lajthishtë.	Nuk është realizuar.
Ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Babimoc.	Nuk është realizuar.
Mbrojtjen e ambientit	Komuna e Obiliqit, me një buxhet simbolik, ka ndërmarrë disa aktivitete për mbrojtjen e mjedisit, mirëpo këto masa janë të pamjaftueshme për të pasur një ndikim të madh në mjedis. Përkundër projekteve disa milionëshe të Bankës Botërore për mbulimin e hirit të termocentraleve, pyllëzimin e kodrave të hirit, etj., gjenjda e ambientit dhe cilësisë së ajrit në këtë komunë mbetet një ndër më të rëndat në Evropë.
Partneritet me KEK-un për t'iu ofruar lehtësira në shërbime banorëve të Obiliqit.	Banorët e Obiliqit nuk kanë asnjë lehtësi nga KEK-u, trajtohen njësoj si konsumatorët e tjerë të vendit. Obiliqi është njëra nga komunat e cila ka reduktime të shpeshta të rrymës. Autoritetet komunale kanë bërë përpjekje serioze që të ndikojnë në KEK që kjo e fundit t'i zbusë masat e reduktimeve ndaj Obiliqit, por KEK-u nuk ka bërë ndonjë veprim konkret në këtë drejtim.

## 11. Burimet:

1. Komuna e Obiliqit. Shpenzimet reprezentative 2011.
2. Komuna e Obiliqit. Raporti i Punës i Kryetarit të Komunës 2011.
3. Komuna e Obiliqit. Raporti Gjashtë Mujor i Punës 2010.
4. Zyra e Auditorit të përgjithshëm. Raporti i Auditorit për Komunën e Obiliqit për vitin 2011. Burimi: [http://www.oagrks.org/repository/docs/Obiliqi\\_31\\_12\\_2011\\_Final\\_alb\\_801244.pdf](http://www.oagrks.org/repository/docs/Obiliqi_31_12_2011_Final_alb_801244.pdf)
5. Komuna e Obiliqit. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Obiliqit. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/obiliq/>
6. Ministria e Financave e Kosovës. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. [http://mf.rksgov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiendrore.aspx](http://mf.rksgov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxheti/endrore.aspx)
7. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Raportet vjetore 2010 -2011. Burimi: [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu_OpenNode=90)
8. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Obiliqit. Burimi: [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu\\_OpenNode=114](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114)
9. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Njoftimet e shpallura për Komunen e Obiliqit. Burimi: [http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2010/furnz\\_drupreje\\_korrik10.pdf](http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2010/furnz_drupreje_korrik10.pdf)
10. Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës. Raportet Vjetore për vitet 2010 dhe 2011. Burimi: [http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/raporti\\_2010\\_509186.pdf](http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/raporti_2010_509186.pdf), dhe [http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/Raporti\\_Vjetori\\_2011\\_972731.pdf](http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/Raporti_Vjetori_2011_972731.pdf)